



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 419/1 prot.

Tiranë, më 20.1. 2023

URDHËR

Nr. 29, datë 20.1. 2023

PËR

**MIRATIMIN E STANDARDEVE PROFESIONALE TË MËSUESIT NDIHMËS NË
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe shkronjës “d” të pikës 5 të kreut III të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”,


U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e standardeve profesionale të mësuesit ndihmës në arsimin parauniversitar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtori të rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar, publike dhe private.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI





STANDARDET PROFESSIONALE TË MËSUESIT NDIHMËS NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR



PËRMBAJTJA

PJESA E PARË	4
HYRJE.....	4
KUJT I SHËRBEJNË STANDARDET PROFESIONALE?.....	5
STRUKTURA E STANDARDEVE PROFESIONALE.....	6
PJESA E DYTË.....	6
STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT NDIHMËS.....	6
Përshkrim përbledhës.....	6
STANDARDI 1: Njohja dhe zbatimi i politikave arsimore për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara	8
STANDARDI 2: Zhvillimi i fëmijës dhe veçoritë e tij.....	9
STANDARDI 3: Mjedisi i të nxenit.....	10
STANDARDI 4: Njohuri për përbajtjen kurrikulare.....	12
STANDARDI 5: Vlerësimi	13
STANDARDI 6: Planifikimi dhe strategjitet e mësimdhënies.....	14
STANDARDI 7: Komunikimi dhe bashkëpunimi	15
STANDARDI 8: Zhvillimi profesional dhe personal	17

Standardet profesionale të mësuesit ndihmës u hartuan nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), mundësuar nga bashkëpunimi me UNDP, përmes Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas/Leave No One Behind” LNB, që mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)

© Copyright 2022

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për ASCAP, Tiranë, Shqipëri

PJESA E PARË

HYRJE

Arsimi gjithëpërfshirës dhe veçanërisht mbështetja e zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara mbetet një nga priorititetet e politikës tonë për arsimin parauniversitar. Profili i mësuesit ndihmës është përcaktuar tashmë si një profesion i rregulluar dhe gjithnjë e më shumë në shkollat tona punojnë mësuesit e licencuar si mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Aktualisht synohet një arsim parauniversitar cilësor dhe gjithëpërfshirës që krijon kushte që nxënësit të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike; të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë. Atributet dhe rolet profesionale të mësuesve njihen dhe forcohen përmes kompetencave/standardeve profesionale që marrin parasysh kompleksitetin e praktikës së mësimdhënies, kulturës së shkollës si dhe proceset zhvillimore që karakterizojnë avancimin në profesion të mësuesve, nga një mësues i apo diplomuar te një profesionist shumë i aftë.

Standardet profesionale për mësuesit ndihmës ndjekin dhe pasojnë standardet e përgjithshme të mësuesit të miratuara dhe shpallura nga MAS. Standardet e përgjithshme të mësuesit i referohen të gjithë punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar. Si të tilla ato janë të detyrueshme të ndiqen nga mësuesit ndihmës. Në vazhdim dhe plotësim të tyre, standardet profesionale të mësuesit ndihmës përpiken të përcaktojnë në mënyrë më të detajuar dhe harmonizuar njohuritë, aftësitet, qëndrimet dhe vlerat profesionale të mësuesit ndihmës në lidhje me mbështetjen e zhvillimit dhe edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar në Shqipëri.

Ky dokument vjen për të plotësuar paketën e zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës. Të gjithë mësuesve ndihmës që janë në shërbim u është krijuar mundësia e zhvillimit profesional. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional, i orientuar me standarde dhe tregues të matshëm, do të ndihmojë çdo mësues të “rritet” dhe të vlerësojë performancën e vet.

KUJT I SHËRBEJNË STANDARDET PROFESIONALE?

Standaret profesionale të mësuesit ndihmës përfshijnë atë që pritet të njohë, të kuptojë, të zotërojë dhe të demonstrojë mësuesi ndihmës në procesin e edukimit dhe mbështetjes së zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- a) Standaret profesionale të mësuesit ndihmës i shërbejnë në radhë të parë vetë mësuesit. Mësuesi mbështetet në to përfshin performancën e tij, duke dalluar anët e tij të fortë dhe nevojat, si dhe përfshin performancën e tij profesional. Standaret përfshijnë një sërë treguesish të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, përfshinë cilat mësuesi ndihmës tregon angazhimin përfshinë kryerjen me sukses të rolit të tij në shkollë. Përmbytja e standardeve profesionale mbështet mësuesin përfshinë progresin e tij në karrierë dhe përfshinë kualifikimin e tij.
- b) Standaret profesionale të mësuesit ndihmës i shërbejnë drejtuesit të shkollës në mënyrë që të përbledhë nevojat profesionale të mësuesve ndihmës dhe mbi këtë bazë të hartojë dhe të zbatojë planin e zhvillimit profesional të tyre.
- c) Standaret profesionale të mësuesit ndihmës i shërbejnë prindit të fëmijës me AK përfshinë përcaktuar pritshmëritë dhe bashkëpunimin formal e jo formal që duhet të krijojë me mësuesin ndihmës.
- d) Standaret profesionale të mësuesit ndihmës i shërbejnë rrjetit profesional të mësuesve ndihmës dhe shërbimit psiko - social në shkollë, të cilët mund t'i përdorin këto standarde përfshirësimin e procesit të mësimdhënie-nxënies dhe zhvillimin e vazhduar profesional të mësuesve.
- e) Standaret profesionale të mësuesit ndihmës i shërbejnë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përfshinë formulimin e politikave mbarëkombëtare të zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe përfshinë hartuar udhëzime, urdhra dhe rregullore që kanë të bëjnë me mësuesit ndihmës dhe rolin e tyre në procesin e edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- f) Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) mbi bazën e këtyre kompetencave identifikon nevojat e mësuesve ndihmës përfshinë zhvillim profesional dhe harton programe e module trajnimi në nivel kombëtar. Gjithashtu, ky institucion ndihmon mësuesit ndihmës dhe shkollat në vlerësimin e performancës së tyre.
- g) Drejtoretë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore Arsimore (ZVA) duke u mbështetur në standaret profesionale të mësuesit ndihmës hartojnë planet e zhvillimit

profesional të mësuesve ndihmës, si dhe planifikojnë veprimtaritë e rrjeteve profesionale të tyre.

- h) Fakultetet e edukimit mbështeten në këto standarde për të hartuar në koherencë standardet e formimit fillestare të mësuesve ndihmës, si dhe për të mundësuar përmes kurrikulës së fushës së pedagogjisë speciale përgatitjen e mësuesve ndihmës në lidhje me to.
- i) Organizatat dhe institucionet që punojnë në fushën e arsimit, mund ta përdorin dokumentin e standardeve profesionale në mënyrë që të ideojnë bashkëpunime të suksesshme me institucionet arsimore dhe që të përzgjedhin më mirë kontributet e tyre në arsim.

STRUKTURA E STANDARDEVE PROFESIONALE

Standardet profesionale të mësuesit ndihmës janë pohime, të cilat harmonizojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat profesionale të mësuesit ndihmës në lidhje me edukimin dhe mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. Struktura e standardit përban titullin e standardit dhe përshkrimin e përbledhur të standardit. Çdo standard zbërthehet në disa tregues të detajuar dhe të matshëm, të cilët u referohen në mënyrë të harmonizuar njohurive që duhet të zotërojë mësuesi ndihmës, klasifikojnë aftësitë që duhet të demonstrojë ai dhe reflektojnë qëndrimet apo vlerat që e karakterizojnë atë gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies.

PJESA E DYTË

STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT NDIHMËS

Përshkrim përbledhës

Standardet profesionale të mësuesit ndihmës janë hartuar duke u bazuar në dokumente të hartuara më parë, siç janë Standardet Profesionale të Formimit të Përgjithshëm të Mësuesit. Këto standarde janë zbërthyer në tregues, të cilët e ndihmojnë mësuesin ndihmës dhe të tjerët që të përcaktojnë nëse është përbushur dhe në ç 'shkallë është përbushur një standard i caktuar. Standardet nuk

mund tē jenë tē ndara prerazi nga njëri-tjetri, përkundrazi janë tē ndërlidhura dhe duhen menduar si pjesë ë një tē tere. Standardet nuk e kufizojnë origjinalitetin dhe krijimtarinë e mësuesit ndihmës, madje e nxisin atë. Ato unifikojnë pretendimet profesionale dhe etike në lidhje me zhvillimin profesional tē mësuesit ndihmës pér fëmijët me aftësi tē kufizuara në arsimin parauniversitar.

Standardi “Njohja dhe zbatimi i politikave arsimore pér edukimin e fëmijëve me aftësi tē kufizuara” i referohet njohurive në lidhje me politikat arsimore dhe me prioritetet kombëtare dhe institucionale mbi rolin e mësuesit ndihmës.

Standardi “Zhvillimi i fëmijës dhe veçoritë e tij” vendos në fokus njohuritë dhe aftësitë që duhet tē zotërojë mësuesi në lidhje me karakteristikat dhe veçoritë e zhvillimit të fëmijës me aftësi tē kufizuara, në mënyrë tē veçantë tē mësimdhënies së bazuar në projekte dhe në zgjidhjen e problemeve që kërkojnë hulumtim dhe bashkëpunim.

Standardi “Mjedisi i tē nxëniti” përfshin treguesit që lidhen me modifikimin e mjedisit mësimor dhe strukturimin e tij pér tē inkurajuar pavarësinë, vetë-motivimin, vetëdrejtimin dhe fuqizimin personal tē fëmijës me aftësi tē kufizuara.

Standardi “Njohuri pér përbajtjen kurrikulare” vendos në fokus njohuritë dhe aftësitë që duhet tē zotërojë mësuesi ndihmës në përdorimin e njohurive tē kurrikulës së përgjithshme dhe asaj tē arsimit special pér tē individualizuar tē nxëniti pér fëmijët me aftësi tē kufizuara.

Standardi “Vlerësimi” i kushtohet njohurive dhe aftësive tē përdorimit tē duhur tē llojeve tē ndryshme tē vlerësimit dhe bashkëpunimit me mësuesin e klasës, familjet dhe kolegët pér tē siguruar vlerësim tē paanshëm dhe efektiv.

Standardi “Planifikimi dhe strategjitë e mësimdhënies” vendos në fokus njohuritë dhe aftësitë pér tē përzgjedhjen, përshtatjen dhe përdorimin nga mësuesi ndihmës tē repertorit tē strategjive mësimore, në promovimin e rezultateve pozitive tē tē nxëniti tē fëmijës me aftësi tē kufizuara.

Standardi “Komunikimi dhe bashkëpunimi” i kushtohet njohurive dhe aftësive tē sigurimit tē bashkëpunimit tē ngushtë dhe krijimit tē ekipeve arsimore bashkëpunuese pér tē adresuar nevojat arsimore tē nxënësve.

Standardi “Zhvillimi profesional dhe personal” fokusohet te përdorimi i njohurive themelore të fushës dhe parimet e tij profesionale etike për të mbështetur praktikën profesionale në fushën e pedagogjisë speciale.

STANDARDI 1: Njohja dhe zbatimi i politikave arsimore për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara

1.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës kuption bazat filozofike, historike dhe ligjore të edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mësuesi ndihmës zoteron njohuri në lidhje me politikat arsimore, priorititet kombëtare dhe institucionale mbi edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mësuesit ndihmës në procesin e mësimdhënies/nxënies së tyre. Ai zbaton parimet, orientimet dhe priorititetet e politikave arsimore në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara duke i përshtatur ato në procesin mësimor. Mësuesi, gjithashtu, sugjeron rishikime dhe përmirësime të çështjeve që lidhen me zbatimin e tyre.

1.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 1.2.1 njeh politikat arsimore në lidhje me rolin e mësuesit ndihmës dhe veçoritë e edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar;
- 1.2.2 identifikon orientimet dhe përparësitë e politikave kombëtare dhe institucionale në lidhje me edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 1.2.3 zberthen, përshtat dhe zbaton orientimet dhe përparësitë e politikave arsimore në nivel institucioni/shkolle dhe klase;
- 1.2.4 njeh dhe zbaton kuadrin ligjor dhe rregullator që lidhet me detyrat e mësuesit ndihmës dhe arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 1.2.5 analizon çështjet që lindin në procesin e zbatimit të politikave në nivel shkolle dhe klase;
- 1.2.6 sugjeron përmirësime të çështjeve që lidhen me zbatimin e politikave arsimore në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara;
- 1.2.7 kryen aktivitetin profesional në përputhje me kërkesat e ligjit, urdhreve, udhëzimeve dhe rregulloreve në sistemin arsimor parauniversitar.

1.3 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës kupton bazat filozofike, historike dhe ligjore të edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mësuesi ndihmës zotëron njohuri në lidhje me politikat arsimore, prioritetet kombëtare dhe institucionale mbi edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mësuesit ndihmës në procesin e mësimdhënies/nxënies së tyre. Ai zbaton parimet, orientimet dhe prioritetet e politikave arsimore në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara duke i përshtatur ato në procesin mësimor. Mësuesi, gjithashtu, sugjeron rishikime dhe përmirësime të çështjeve që lidhen me zbatimin e tyre.

1.4 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 1.4.1 njeh politikat arsimore në lidhje me rolin e mësuesit ndihmës dhe veçoritë e edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar;
- 1.4.2 identifikon orientimet dhe përparësitë e politikave kombëtare dhe institucionale në lidhje me edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 1.4.3 zbërthen, përshtat dhe zbaton orientimet dhe përparësitë e politikave arsimore në nivel institucioni/shkolle dhe klase;
- 1.4.4 njeh dhe zbaton kuadrin ligjor dhe rregullator që lidhet me detyrat e mësuesit ndihmës dhe arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 1.4.5 analizon çështjet që lindin në procesin e zbatimit të politikave në nivel shkolle dhe klase;
- 1.4.6 sugjeron përmirësime të çështjeve që lidhen me zbatimin e politikave arsimore në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara;
- 1.4.7 kryen aktivitetin profesional në përputhje me kërkesat e ligjit, urdhërave, udhëzimeve dhe rregulloreve në nivel sistemi arsimor dhe lokal.

STANDARDI 2: Zhvillimi i fëmijës dhe veçoritë e tij

2.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës kupton veçoritë e fëmijës me aftësi të kufizuara dhe njeh dallimet mes fëmijëve me dhe pa aftësi të kufizuara. Gjithashtu ai kupton se si nevojat e veçanta ndikojnë në procesin e zhvillimit dhe të nxënët e fëmijës/nxënësit. Mësuesi ndihmës kupton se këto dallime në të nxënë përbëjnë bazën e mësimdhënies së individualizuar në mbështetje të zhvillimit dhe edukimit të fëmijës me aftësi të kufizuara. Mësuesi ndihmës i përdor këto njoħuri për tē ofruar përvoja mësimore efektive dhe sfiduese për fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara.

2.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 2.2.1 njeh dhe vlerëson problematikat dhe vështirësitet që paraqet nxënësi si dhe nevojat arsimore e mundësitet e tij zhvillimore;
- 2.2.2 përdor të kuptuarit e zhvillimit dhe dallimet individuale për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 2.2.3 përdor njoħuritë për veçoritë njoħese, komunikuese, fizike, kulturore, sociale dhe emocionale të fëmijës në planifikimin dhe përgatitjen e veprimtarive mësimore si dhe në planifikimin e individualizuar;
- 2.2.4 rekomandon referime tek specialistët e duhur kur kërcohët informacion më i thellë për nevojat e fëmijës për marrjen e vendimeve për arsimimin e tij;
- 2.2.5 kupton se si gjuha, kultura dhe familja ndërveprojnë dhe kanë ndikim në aftësitë akademike dhe sociale, interesat dhe qëndrimet e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 2.2.6 kupton veçoritë e fëmijës me aftësi të kufizuara dhe njeh dallimet mes fëmijëve me dhe pa aftësi të kufizuara.

STANDARDI 3: Mjedisi i të nxënët

3.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës modifikon dhe përshtat mjedisin e të nxënët për nevojat individuale të fëmijës/nxënësit me aftësi të kufizuara. Njoħuritë në lidhje me veçoritë e zhvillimit të fëmijës, familjen dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm kontekstualë e udhëzojnë mësuesin ndihmës në modifikimin e mjedisit mësimor. Mësuesi ndihmës strukturon mjedisin/et pér tē inkurajuar

pavarësinë, vetë-motivimin, vetëdrejtimin dhe fuqizimin personal të fëmijës me aftësi të kufizuara dhe i mëson ata të përshtaten me pritshmëritë dhe kërkesat e mjediseve të ndryshme. Mësuesi ndihmës krijon mjedise mësimore të sigurta dhe gjithëpërfshirëse në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të bëhen individë aktivë dhe të zhvillojnë mirëqenien emocionale dhe ndërveprimet pozitive sociale.

3.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 3.2.1 krijon mjedise të sigurta, miqësore dhe gjithëpërfshirëse për të angazhuar fëmijët me aftësi të kufizuara në veprimtari të nxëni dhe ndërveprime sociale, përmes bashkëpunimit me drejtuesit, mësuesit e klasës dhe kolegë e tjerë;;
- 3.2.2 angazhohet në krijimin e një mjedisi pranues, inkurajes dhe motivues për fëmijën me aftësi të kufizuara në klasë, shkollë dhe komunitet;
- 3.2.3 përdor ndërhyrje motivuese dhe udhëzuese për t'i mësuar fëmijës me aftësi të kufizuara se si të përshtatet me mjedise të ndryshme;
- 3.2.4 identifikon, përdor dhe vlerëson përfocuesit e duhur për të rritur të nxënët dhe motivimin;
- 3.2.5 përdor strategji dhe teknika për të rregulluar dhe modifikuar mjesidin e të nxënët sipas karakteristikave fizike, shqisore të fëmijës dhe/ose nevojave të sjelljes;
- 3.2.6 përgatit, strukturon dhe menaxhon në mënyrë efektive rutinat e përditshme të fëmijës, duke përfshirë kohën e tranzicionit nga një mjedis në tjetrin;
- 3.2.7 përdor teknologjinë ndihmëse, kur është e aplikueshme, për të krijuar, rregulluar dhe mbajtur një mjedis pozitiv që lehtëson të nxënët dhe ndërveprimin;
- 3.2.8 monitoron dhe analizon ndryshimet në sjelljen dhe performancën individuale dhe grupore të fëmijës;
- 3.2.9 zhvillon, zbaton dhe vlerëson efektet e teknikave të ndërhyrjes së sjelljes pozitive dhe planet e ndërhyrjes individuale të sjelljes të fëmijës me aftësi të kufizuara;
- 3.2.10 zgjedh sjelljet e synuara që do të ndryshohen dhe kryen një vlerësim funksional të sjelljes së synuar;
- 3.2.11 koordinon aktivitetet me personelin e shërbimeve përkatëse në shkollë për të maksimizuar mësimin dhe të nxënët.

STANDARDI 4: Njohuri për përmbajtjen kurrikulare

4.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës përdor njohuritë e kurrikulës së përgjithshme dhe asaj të arsimit special për të individualizuar të nxënët përfshirë me aftësi të kufizuara. Në kuadër të kurrikulave të arsimit të përgjithshëm, mësuesi ndihmës demonstron të kuptuar të mirë të koncepteve kryesore, strukturës së lëndëve dhe metodologjinë e zberthimit të përmbajtjes së lëndëve, kur planifikon dhe zhvillon veprimtari mësimore. Në këtë mënyrë ai është në gjendje të organizojë njohuritë, të mundësojë integrimin e aftësive ndërdisiplinore dhe të bashkëpunojë me mësuesit e zakonshëm të klasës.

4.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 4.2.1 kupton konceptet kryesore, strukturën e lëndëve dhe përmbajtjen e fushave kurrikulare që jep mësim dhe mund të organizojë këto njohuri, të integrojë aftësi ndërlendore dhe të nxisë përparim në të nxënët e fëmijës me aftësi të kufizuara;
- 4.2.2 kupton dhe përdor njohuritë e përgjithshme dhe të specializuara të përmbajtjes në të gjithë fushat kurrikulare përfshirë individualizuar mësimdhënien përfshirë me aftësi të kufizuara;
- 4.2.3 modifikondhe përshtat kurrikulat e përgjithshme dhe të specializuara përfshirë ato të aksesueshme dhe përdorshme përfshirë me aftësi të kufizuara;
- 4.2.4 përzgjedh, zbaton dhe vlerëson programet mësimore, apo pjesë të tyre, që rrisin pjesëmarrjen sociale të fëmijës në aktivitetet e klasës, shkollës, familjes dhe komunitetit;
- 4.2.5 përzgjedh dhe zhvillon kurrikulat që kanë në fokus fushat e aftësive përfshirë jetën: shtëpiakë, rekreacion/kohë të lirë, profesionale, komunitare etj;
- 4.2.6 vlerëson burimet mësimore dhe materialet kurrikulare përfshirë gjithëpërfshirjen, saktësinë dhe dobinë e tyre;
- 4.2.7 ofron dhe rekomandon përfshirë prindin materiale didaktike dhe përmbajtje kurrikulare që mbështesin të nxënët e fëmijës me aftësi të kufizuara.

STANDARDI 5: Vlerësimi

5.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës përdor metoda të shumta vlerësimi dhe burime të dhënash në marrjen e vendimeve pedagogjike. Ai kupton përdorimin e duhur dhe kufizimet e llojeve të ndryshme të vlerësimit dhe bashkëpunon me mësuesit e klasës, familjet dhe kolegët për të siguruar vlerësim të paanshëm dhe kuptimplotë. Ai kryen vlerësime formale dhe joformale të sjelljes, të të nxënësve dhe arritjeve për të individualizuar përvojat e të nxënësve që mbështesin rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

5.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 5.2.1 përdor metoda të ndryshme vlerësimi për arritjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara bazuar në pritshmëritë e përcaktuara në Planin Edukativ Individual;
- 5.2.2 zgjedh dhe përdor vlerësime formale dhe joformale profesionalisht korrekte, që minimizojnë paragjykimet;
- 5.2.3 krijon dhe mban shënimë të qarta dhe të sakta për progresin dhe arritjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 5.2.4 inkurajon përpjekjet e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe njeh e motivon mundësitë dhe arritjet e tij;
- 5.2.5 përdor njohuritë mbi parimet dhe praktikat e matjes së arritjeve për të interpretuar rezultatet e vlerësimit dhe për të udhëhequr vendimet pedagogjike për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- 5.2.6 përdor lloje të ndryshme vlerësimi dhe grumbullimi të dhënash, në bashkëpunim me kolegët dhe familjen, për të mundësuar marrjen e vendimeve për fëmijën me aftësi të kufizuara. dhe raportimin e rezultateve;
- 5.2.7 bashkëpunon me familjet dhe profesionistë të tjera në kryerjen e vlerësimit individual dhe raportimin e rezultateve të vlerësimit;
- 5.2.8 përdor të dhënat e performancës për të bërë ose sugjeruar modifikimin e duhur në mjetet e nxënësve, kurrikulën e zbatuar dhe/ose strategjitet mësimore;

- 5.2.9 Informon prindërit ose kujdestarët në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike për ecurinë e fëmijës.

STANDARDI 6: Planifikimi dhe strategjitë e mësimdhënies

6.1 Përshkrimi i standardit

Vendimmarja e individualizuar dhe mësimdhënia e individualizuar janë në qendër të praktikës së pedagogjisë speciale. Në përgjedhjen, zhvillimin dhe përshtatjen e përvojave të të nxenit përfëmijët me aftësi të kufizuara, mësuesit ndihmës marrin parasysh aftësitë, interesat, mjediset e tē nxenit dhe faktorët kulturorë dhe gjuhësorë. Ndërveprimet e këtyre faktorëve me implikimet e paaftësisë së fëmijës orientojnë përgjedhjen, përshtatjen dhe përdorimin nga mësuesi ndihmës tē repertorit të strategjive mësimore, në promovimin e rezultateve pozitive të tē nxenit në përgjithësi dhe kurrikulës së specializuar si dhe modifikimin e mjediseve mësimore në mënyrë tē përshtatshme përfëmijët me aftësi të kufizuara.

6.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 6.2.1 zhvillon plane edukative mësimore tē përshtatshme që zërthejnë kurrikulën zyrtare dhe strategjitë mësimdhënëse me qëllime dhe standarde të individualizuar arsimore.
- 6.2.2 zhvillon dhe zbaton plane edukative individuale përfëmijët me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me kolegë, familjet dhe specialistë tē fushës;
- 6.2.3 përgatit në bashkëpunim me mësuesin e klasës, anëtarë tē tjerë tē stafit tē shkollës dhe prindin, materiale didaktike dhe mjete tē thjeshta mësimore përf tē mbështetur tē nxenit e fëmijës me aftësi të kufizuara;
- 6.2.4 vlerëson kurrikulën e përgjithshme dhe përcakton shtrirjen dhe renditjen e fushave tē përmbytjeve akademike;

- 6.2.5 zgjedh dhe vlerëson burime dhe materiale që janë të vlefshme në aspektin zhvillimor dhe funksional të fëmijës me aftësi të kufizuara;
- 6.2.6 zgjedh, përshtat dhe përdor një repertor të gjerë të strategjive mësimore të bazuara në evidenca, për të nxitur dhe mbështetur të nxënит;
- 6.2.7 zgjedh dhe përdor strategjitet e duhura mësimdhënëse për të përbushur objektivat/rezultatet mësimore;
- 6.2.8 merr parasysh aftësitë individuale, interesat, mjediset e të nxënit dhe faktorët kulturorë dhe gjuhësorë në përgjedhjen, zhvillimin dhe përshtatjen e strategjive të mësimdhënies dhe nxënit përf mësimjët me aftësi të kufizuara;
- 6.2.9 përdor teknologjinë përf të mbështetur vlerësimin, planifikimin, mësimdhënien dhe të nxënit përf mësimjët me aftësi të kufizuara;
- 6.2.10 përdor strategji përf të rritur zhvillimin gjuhësor dhe aftësitë e komunikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 6.2.11 ndërton veprimtari mësimore bazuar në njoħuri dhe aftësi ndërdisiplinore si mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve përf mësimjët me aftësi të kufizuara.

STANDARDI 7: Komunikimi dhe bashkëpunimi

7.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës bashkëpunon me familjet, kujdestarët, mësuesit e tjerë, ofruesit e shërbimeve përkatëse, individët me aftësi të kufizuara dhe personelin nga agjencitë e komunitetit në mënyrë të përgjegjshme përf të adresuar nevojat e fëmijës me aftësi të kufizuara në një sërë përvojash të të mësuarit. Një nga kérkesat e rëndësishme në arsim është krijimi i ekipeve arsimore bashkëpunuese përf të adresuar nevojat edukuese të nxënësve. Diversiteti i nxënësve, kompleksiteti i kérkesave kurrikulare, ndikimi në rritje i teknologjisë ka nxjerrë në pah nevojën përf ekipe edukatorësh që bashkëpunojnë së bashku përf të siguruar që të gjithë nxënësit janë përfshirë në procesin e të nxënit efektiv.

7.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 7.2.1 përdor elementet e komunikimit e bashkëpunimit efektiv dhe shërben si mbështetje për kolegët;
- 7.2.2 e ndjen veten si pjesë të një ekipi që punon për të njëtin qëllim dhe e koncepton e planifikon punën e tij duke u mbështetur e bashkëpunuar me mësuesit, drejtuesit, shërbimin psiko-social, prindin dhe komunitetin;
- 7.2.3 i sheh mësuesit e klasës si bashkëpunëtorët kryesorë në mbështetje të zhvillimit dhe edukimit të fëmijës me aftësi të kufizuara dhe për të krijuar një mjedis efektiv të nxëni për të;
- 7.2.4 mirëpret dhe nxit nismat e kolegëve për përmirësimin e kushteve të të nxënët;
- 7.2.5 mbështet dhe ndihmon mësuesit ndihmës të rinx;
- 7.2.6 bashkëpunon në ekip, duke përfshirë familjet, për të zhvilluar dhe zbatuar planin edukativ individual të fëmijës dhe mbështetjen në zhvillimin e eksperiencave të ndryshme të të nxënët;
- 7.2.7 e përdor bashkëpunimin për të promovuar mirëqenien e fëmijëve me aftësi të kufizuara në një gamë të gjerë mjedisesh dhe bashkëpunëtorësh;
- 7.2.8 bashkëpunon dhe përfshin familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuar në të gjithë aspektet e edukimit të fëmijës;
- 7.2.9 inkurajon dhe mbështet familjet në programet e edukimit të fëmijëve të tyre dhe i nxit për t'u bërë pjesëmarrës aktivë në ekipin edukativ;
- 7.2.10 u siguron prindërve informacionet e nevojshme dhe në kohën e duhur për arritjet e fëmijës së tyre;
- 7.2.11 bashkëpunon dhe koordinon me anëtarë të shërbimit psiko social në shkollë dhe në rajonin ku shkolla funksionon.
- 7.2.12 bashkëpunon me profesionistë në qendrat komunitare të shërbimeve sociale dhe institucionale të tjera të specializuara në komunitetin e institucionit arsimor.

STANDARDI 8: Zhvillimi profesional dhe personal

8.1 Përshkrimi i standardit


Mësuesi ndihmës përdor njohuritë themelore të fushës dhe parimet e tij profesionale dhe etike për të mbështetur praktikën e pedagogjisë speciale, për t'u angazhuar në të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe për të avancuar profesionalisht. Mësuesi ndihmës e kpton mësimdhënien si profesion, ruan standarde e sjelljes profesionale dhe siguron udhëheqje për të përmirësuar të nxënët dhe mirëqenien e fëmijëve.

8.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 8.2.1 përdor parimet e etikës profesionale dhe standarde profesionale për të udhëhequr praktikën e tyre të përditshme;
- 8.2.2 shfrytëzon të gjitha burimet dhe mundësitë për zhvillimin e tij profesional në fushën e arsimit special;
- 8.2.3 kupton se si njohuritë themelore dhe çështjet aktuale ndikojnë në praktikën profesionale;
- 8.2.4 reflekton mbi praktikën e tij/saj për të përmirësuar mësimdhënien dhe për të udhëhequr rritjen profesionale;
- 8.2.5 kupton rëndësinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe merr pjesë në aktivitetet profesionale dhe komunitetet profesionale të të mësuarit;
- 8.2.6 siguron që plani i tij/saj i zhvillimit profesional të përfshijë aktivitete që do të mbeten aktuale në lidhje me praktikën mësimdhënëse dhe nxënëse;
- 8.2.7 studion rregullisht literaturë profesionale nga burime të ndryshme, përfshirë dhe atë elektronike, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj;
- 8.2.8 ofron udhëzime dhe orientim për prindërit, mësuesit praktikantë dhe vullnetarët.
- 8.2.9 vlerëson rregullisht veten mbi bazën e standardeve profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit dhe standardeve të mësuesit ndihmës;
- 8.2.10 njeh shenjat e shqetësimit emocional, abuzimit të fëmijëve dhe neglizhencës dhe ndjek procedurat për raportimin e abuzimit tek autoritetet përkatëse;
- 8.2.11 ruan konfidencialitetin e të dhënavë mjekësore dhe akademike dhe respekton privatësinë e individëve me aftësi të kufizuara;

- | | |
|--|--|
| <p>8.2.12 përdor me efektivitet kohën e punës;</p> <p>8.2.13 kujdeset për kushtet shëndetësore, të higjenës dhe të sigurisë nga rreziqet në mjediset e mësimdhënieς;</p> <p>8.2.14 parandalon dhe përdor metoda të negocimit, të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe të arritjes së konsensusit në marrëdhëni me kolegët, prindërit/kujdestarët e fëmijës dhe bashkëpunëtorë të tjera.</p> | |
|--|--|



19



STANDARDET PROFESSIONALE TË MËSUESIT NDIHMËS NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR



PËRMBAJTJA

PJESA E PARË	4
HYRJE.....	4
KUJT I SHËRBEJNË STANDARDET PROFESIONALE?.....	5
STRUKTURA E STANDARDEVE PROFESIONALE.....	6
PJESA E DYTË.....	6
STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT NDIHMËS.....	6
Përshkrim përmbledhës.....	6
STANDARDI 1: Njohja dhe zbatimi i politikave arsimore për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara	8
STANDARDI 2: Zhvillimi i fëmijës dhe veçoritë e tij.....	9
STANDARDI 3: Mjedisi i të nxënësit.....	10
STANDARDI 4: Njohuri për përmbajtjen kurrikulare.....	12
STANDARDI 5: Vlerësimi.....	13
STANDARDI 6: Planifikimi dhe strategjitet e mësimdhënies.....	14
STANDARDI 7: Komunikimi dhe bashkëpunimi	15
STANDARDI 8: Zhvillimi profesional dhe personal	17

Standardet profesionale të mësuesit ndihmës u hartuan nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), mundësuar nga bashkëpunimi me UNDP, përmes Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas/Leave No One Behind” LNB, që mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)

© Copyright 2022

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për ASCAP, Tiranë, Shqipëri

PJESA E PARË

HYRJE

Arsimi gjithëpërfshirës dhe veçanërisht mbështetja e zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara mbetet një nga priorititetet e politikës tonë për arsimin parauniversitar. Profili i mësuesit ndihmës është përcaktuar tashmë si një profesion i rregulluar dhe gjithnjë e më shumë në shkollat tona punojnë mësuesit e licencuar si mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Aktualisht synohet një arsim parauniversitar cilësor dhe gjithëpërfshirës që krijon kushte që nxënësit të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike; të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë. Atributet dhe rolet profesionale të mësuesve njihen dhe forcohen përmes kompetencave/standardeve profesionale që marrin parasysh kompleksitetin e praktikës së mësimdhënies, kulturës së shkollës si dhe proceset zhvillimore që karakterizojnë avancimin në profesion të mësuesve, nga një mësues i sapo diplomuar te një profesionist shumë i aftë.

Standardet profesionale për mësuesit ndihmës ndjekin dhe pasojnë standardet e përgjithshme të mësuesit të miratuara dhe shpallura nga MAS. Standardet e përgjithshme të mësuesit i referohen të gjithë punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar. Si të tilla ato janë të detyrueshme të ndiqen nga mësuesit ndihmës. Në vazhdim dhe plotësim të tyre, standardet profesionale të mësuesit ndihmës përpilen të përcaktojnë në mënyrë më të detajuar dhe harmonizuar njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat profesionale të mësuesit ndihmës në lidhje me mbështetjen e zhvillimit dhe edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar në Shqipëri.

Ky dokument vjen për të plotësuar paketën e zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës. Të gjithë mësuesve ndihmës që janë në shërbim u është krijuar mundësia e zhvillimit profesional. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional, i orientuar me standarde dhe tregues të matshëm, do të ndihmojë çdo mësues të “rritet” dhe të vlerësojë performancën e vet.

KUJT I SHËRBEJNË STANDARDET PROFESIONALE?

Standaret profesionale të mësuesit ndihmës përfshijnë atë që pritet të njohë, të kuptojë, të zotërojë dhe të demonstrojë mësuesi ndihmës në procesin e edukimit dhe mbështetjes së zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- a) Standaret profesionale të mësuesit ndihmës i shërbejnë në radhë të parë vetë mësuesit. Mësuesi mbështetet në to përfshijnë performancën e tij, duke dalluar anët e tij të fortë dhe nevojat, si dhe përfshijnë treguesish të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, përfshijnë cilat mësuesi ndihmës tregon angazhimin përfshijnë kryerjen me sukses të rolit të tij në shkollë. Përmblidhja e standardeve profesionale mbështet mësuesin përfshijnë progresin e tij në karrierë dhe përfshijnë kualifikimin e tij.
- b) Standaret profesionale të mësuesit ndihmës i shërbejnë drejtuesit të shkollës në mënyrë që të përmblidhë nevojat profesionale të mësuesve ndihmës dhe mbi këtë bazë të hartojë dhe të zbatojë planin e zhvillimit profesional të tyre.
- c) Standaret profesionale të mësuesit ndihmës i shërbejnë prindit të fëmijës me AK përfshijnë përcaktuar pritshmëritë dhe bashkëpunimin formal e jo formal që duhet të krijojë me mësuesin ndihmës.
- d) Standaret profesionale të mësuesit ndihmës i shërbejnë rrjetit profesional të mësuesve ndihmës dhe shërbimit psiko - social në shkollë, të cilët mund t'i përdorin këto standarde përmirësimin e procesit të mësimdhënie-nxënies dhe zhvillimin e vazhduar profesional të mësuesve.
- e) Standaret profesionale të mësuesit ndihmës i shërbejnë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përfshijnë formulimin e politikave mbarëkombëtare të zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe përfshijnë hartuar udhëzime, urdhra dhe rregullore që kanë të bëjnë me mësuesit ndihmës dhe rolin e tyre në procesin e edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- f) Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) mbi bazën e këtyre kompetencave identifikon nevojat e mësuesve ndihmës përfshijnë profesional dhe harton programe e module trajnimi në nivel kombëtar. Gjithashtu, ky institucion ndihmon mësuesit ndihmës dhe shkollat në vlerësimin e performancës së tyre.
- g) Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore Arsimore (ZVA) duke u mbështetur në standaret profesionale të mësuesit ndihmës hartojnë planet e zhvillimit

profesional të mësuesve ndihmës, si dhe planifikojnë veprimtaritë e rrjeteve profesionale të tyre.

- h) Fakultetet e edukimit mbështeten në këto standarde për të hartuar në koherencë standardet e formimit fillestare të mësuesve ndihmës, si dhe për të mundësuar përmes kurrikulës së fushës së pedagogjisë speciale përgatitjen e mësuesve ndihmës në lidhje me to.
- i) Organizatat dhe institucionet që punojnë në fushën e arsimit, mund ta përdorin dokumentin e standardeve profesionale në mënyrë që të ideojnë bashkëpunime të suksesshme me institucionet arsimore dhe që të përzgjedhin më mirë kontributet e tyre në arsim.

STRUKTURA E STANDARDEVE PROFESIONALE

Standardet profesionale të mësuesit ndihmës janë pohime, të cilat harmonizojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat profesionale të mësuesit ndihmës në lidhje me edukimin dhe mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. Struktura e standardit përban titullin e standardit dhe përshkrimin e përbledhur të standardit. Çdo standard zbërthehet në disa tregues të detajuar dhe të matshëm, të cilët u referohen në mënyrë të harmonizuar njohurive që duhet të zotërojë mësuesi ndihmës, klasifikojnë aftësitë që duhet të demonstrojë ai dhe reflektojnë qëndrimet apo vlerat që e karakterizojnë atë gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies.

PJESA E DYTË

STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT NDIHMËS

Përshkrim përbledhës

Standardet profesionale të mësuesit ndihmës janë hartuar duke u bazuar në dokumente të hartuara më parë, siç janë Standardet Profesionale të Formimit të Përgjithshëm të Mësuesit. Këto standarde janë zbërthyer në tregues, të cilët e ndihmojnë mësuesin ndihmës dhe të tjerët që të përcaktojnë nëse është përbushur dhe në ç 'shkallë është përbushur një standard i caktuar. Standardet nuk

mund të jenë të ndara prerazi nga njëri-tjetri, përkundrazi janë të ndërlidhura dhe duhen menduar si pjesë ë një të tere. Standardet nuk e kufizojnë origjinalitetin dhe krijimtarinë e mësuesit ndihmës, madje e nxisin atë. Ato unifikojnë pretendimet profesionale dhe etike në lidhje me zhvillimin profesional të mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar.

Standardi “Njohja dhe zbatimi i politikave arsimore për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara” i referohet njohurive në lidhje me politikat arsimore dhe me priorititetet kombëtare dhe institucionale mbi rolin e mësuesit ndihmës.

Standardi “Zhvillimi i fëmijës dhe veçoritë e tij” vendos në fokus njohuritë dhe aftësitë që duhet të zoterojë mësuesi në lidhje me karakteristikat dhe veçoritë e zhvillimit të fëmijës me aftësi të kufizuara, në mënyrë të veçantë të mësimdhënies së bazuar në projekte dhe në zgjidhjen e problemeve që kërkojnë hulumtim dhe bashkëpunim.

Standardi “Mjedisi i të nxënët” përfshin treguesit që lidhen me modifikimin e mjedisit mësimor dhe strukturimin e tij për të inkurajuar pavarësinë, vetë-motivimin, vetëdrejtimin dhe fuqizimin personal të fëmijës me aftësi të kufizuara.

Standardi “Njohuri për përbajtjen kurrikulare” vendos në fokus njohuritë dhe aftësitë që duhet të zoterojë mësuesi ndihmës në përdorimin e njohurive të kurrikulës së përgjithshme dhe asaj të arsimit special për të individualizuar të nxënët për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Standardi “Vlerësimi” i kushtohet njohurive dhe aftësive të përdorimit të duhur të llojeve të ndryshme të vlerësimit dhe bashkëpunimit me mësuesin e klasës, familjet dhe kolegët për të siguruar vlerësim të paanshëm dhe efektiv.

Standardi “Planifikimi dhe strategjité e mësimdhënies” vendos në fokus njohuritë dhe aftësitë për të përzgjedhjen, përshtatjen dhe përdorimin nga mësuesi ndihmës të repertorit të strategjive mësimore, në promovimin e rezultateve pozitive të të nxënët të fëmijës me aftësi të kufizuara.

Standardi “Komunikimi dhe bashkëpunimi” i kushtohet njohurive dhe aftësive të sigurimit të bashkëpunimit të ngushtë dhe krijimit të ekipeve arsimore bashkëpunuese për të adresuar nevojat arsimore të nxënësve.

Standardi “Zhvillimi profesional dhe personal” fokusohet te përdorimi i njohurive themelore të fushës dhe parimet e tij profesionale etike për të mbështetur praktikën profesionale në fushën e pedagogjisë speciale.

STANDARDI 1: Njohja dhe zbatimi i politikave arsimore për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara

1.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës kupton bazat filozofike, historike dhe ligjore të edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mësuesi ndihmës zoteron njohuri në lidhje me politikat arsimore, priorititetet kombëtare dhe institucionale mbi edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mësuesit ndihmës në procesin e mësimdhënies/nxënies së tyre. Ai zbaton parimet, orientimet dhe priorititetet e politikave arsimore në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara duke i përshtatur ato në procesin mësimor. Mësuesi, gjithashtu, sugjeron rishikime dhe përmirësime të çështjeve që lidhen me zbatimin e tyre.

1.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 1.2.1 njeh politikat arsimore në lidhje me rolin e mësuesit ndihmës dhe veçoritë e edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar;
- 1.2.2 identifikon orientimet dhe përparësitë e politikave kombëtare dhe institucionale në lidhje me edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 1.2.3 zbërthen, përshtat dhe zbaton orientimet dhe përparësitë e politikave arsimore në nivel institucioni/shkolle dhe klase;
- 1.2.4 njeh dhe zbaton kuadrin ligjor dhe rregullator që lidhet me detyrat e mësuesit ndihmës dhe arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 1.2.5 analizon çështjet që lindin në procesin e zbatimit të politikave në nivel shkolle dhe klase;
- 1.2.6 sugjeron përmirësime të çështjeve që lidhen me zbatimin e politikave arsimore në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara;
- 1.2.7 kryen aktivitetin profesional në përputhje me kërkesat e ligjit, urdhërave, udhëzimeve dhe rregulloreve në sistemin arsimor parauniversitar.

1.3 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës kupton bazat filozofike, historike dhe ligjore të edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mësuesi ndihmës zotëron njohuri në lidhje me politikat arsimore, prioritetet kombëtare dhe institucionale mbi edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mësuesit ndihmës në procesin e mësimdhënies/nxënies së tyre. Ai zbaton parimet, orientimet dhe prioritetet e politikave arsimore në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara duke i përshtatur ato në procesin mësimor. Mësuesi, gjithashtu, sugjeron rishikime dhe përmirësime të çështjeve që lidhen me zbatimin e tyre.

1.4 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 1.4.1 njeh politikat arsimore në lidhje me rolin e mësuesit ndihmës dhe veçoritë e edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar;
- 1.4.2 identifikon orientimet dhe përparësitë e politikave kombëtare dhe institucionale në lidhje me edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 1.4.3 zbërthen, përshtat dhe zbaton orientimet dhe përparësitë e politikave arsimore në nivel institucioni/shkolle dhe klase;
- 1.4.4 njeh dhe zbaton kuadrin ligjor dhe rregullator që lidhet me detyrat e mësuesit ndihmës dhe arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 1.4.5 analizon çështjet që lindin në procesin e zbatimit të politikave në nivel shkolle dhe klase;
- 1.4.6 sugjeron përmirësime të çështjeve që lidhen me zbatimin e politikave arsimore në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara;
- 1.4.7 kryen aktivitetin profesional në përputhje me kërkesat e ligjit, urdhërave, udhëzimeve dhe rregulloreve në nivel sistemi arsimor dhe lokal.

STANDARDI 2: Zhvillimi i fëmijës dhe veçoritë e tij

2.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës kupton veçoritë e fëmijës me aftësi të kufizuara dhe njeh dallimet mes fëmijëve me dhe pa aftësi të kufizuara. Gjithashtu ai kupton se si nevojat e veçanta ndikojnë në procesin e zhvillimit dhe të nxënët e fëmijës/nxënësit. Mësuesi ndihmës kupton se këto dallime në të nxënë përbëjnë bazën e mësimdhënies së individualizuar në mbështetje të zhvillimit dhe edukimit të fëmijës me aftësi të kufizuara. Mësuesi ndihmës i përdor këto njohuri për të ofruar përvoja mësimore efektive dhe sfiduese për fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara.

2.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 2.2.1 njeh dhe vlerëson problematikat dhe vështirësitë që paraqet nxënësi si dhe nevojat arsimore e mundësitë e tij zhvillimore;
- 2.2.2 përdor të kuptuarit e zhvillimit dhe dallimet individuale për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 2.2.3 përdor njohuritë për veçoritë njohëse, komunikuese, fizike, kulturore, sociale dhe emocionale të fëmijës në planifikimin dhe përgatitjen e veprimtarive mësimore si dhe në planifikimin e individualizuar;
- 2.2.4 rekomandon referime tek specialistët e duhur kur kërkohet informacion më i thellë për nevojat e fëmijës për marrjen e vendimeve për arsimimin e tij;
- 2.2.5 kupton se si gjuha, kultura dhe familja ndërveprojnë dhe kanë ndikim në aftësitë akademike dhe sociale, interesat dhe qëndrimet e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 2.2.6 kupton veçoritë e fëmijës me aftësi të kufizuara dhe njeh dallimet mes fëmijëve me dhe pa aftësi të kufizuara.

STANDARDI 3: Mjedisi i të nxënët

3.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës modifikon dhe përshtat mjedisin e të nxënët për nevojat individuale të fëmijës/nxënësit me aftësi të kufizuara. Njohuritë në lidhje me veçoritë e zhvillimit të fëmijës, familjen dhe faktorë të tjera të rëndësishëm kontekstualë e udhëzojnë mësuesin ndihmës në modifikimin e mjedisit mësimor. Mësuesi ndihmës strukturon mjedisin/et për të inkurajuar

pavarësinë, vetë-motivimin, vetëdrejtimin dhe fuqizimin personal të fëmijës me aftësi të kufizuara dhe i mëson ata të përshtaten me pritshmëritë dhe kërkesat e mjediseve të ndryshme. Mësuesi ndihmës krijon mjedise mësimore të sigurta dhe gjithëpërfshirëse në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të bëhen individë aktivë dhe të zhvillojnë mirëqenien emocionale dhe ndërveprimet pozitive sociale.

3.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 3.2.1 krijon mjedise të sigurta, miqësore dhe gjithëpërfshirëse për të angazhuar fëmijët me aftësi të kufizuara në veprimtari të nxëni dhe ndërveprime sociale, përmes bashkëpunimit me drejtuesit, mësuesit e klasës dhe kolegë e tjerë;;
- 3.2.2 angazhohet në krijimin e një mjedisi pranues, inkurajues dhe motivues për fëmijën me aftësi të kufizuara në klasë, shkollë dhe komunitet;
- 3.2.3 përdor ndërhyrje motivuese dhe udhëzuese për t'i mësuar fëmijës me aftësi të kufizuara se si të përshtatet me mjedise të ndryshme;
- 3.2.4 identifikon, përdor dhe vlerëson përfocuesit e duhur për të rritur të nxënënit dhe motivimin;
- 3.2.5 përdor strategji dhe teknika për të rregulluar dhe modifikuar mjedisin e të nxënënit sipas karakteristikave fizike, shqisore të fëmijës dhe/ose nevojave të sjelljes;
- 3.2.6 përgatit, strukturon dhe menaxhon në mënyrë efektive rutinat e përditshme të fëmijës, duke përfshirë kohën e tranzicionit nga një mjedis në tjetrin;
- 3.2.7 përdor teknologjinë ndihmëse, kur është e aplikueshme, për të krijuar, rregulluar dhe mbajtur një mjedis pozitiv që lehtëson të nxënënit dhe ndërveprimin;
- 3.2.8 monitoron dhe analizon ndryshimet në sjelljen dhe performancën individuale dhe grupore të fëmijës;
- 3.2.9 zhvillon, zbaton dhe vlerëson efektet e teknikave të ndërhyrjes së sjelljes pozitive dhe planet e ndërhyrjes individuale të sjelljes të fëmijës me aftësi të kufizuara;
- 3.2.10 zgjedh sjelljet e synuara që do të ndryshohen dhe kryen një vlerësim funksional të sjelljes së synuar;
- 3.2.11 koordinon aktivitetet me personelin e shërbimeve përkatëse në shkollë për të maksimizuar mësimin dhe të nxënënit.

STANDARDI 4: Njohuri për përmbajtjen kurrikulare

4.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës përdor njohuritë e kurrikulës së përgjithshme dhe asaj të arsimit special për të individualizuar të nxënët përfshirë me aftësi të kufizuara. Në kuadër të kurrikulave të arsimit të përgjithshëm, mësuesi ndihmës demonstron të kuptuar të mirë të koncepteve kryesore, strukturës së lëndëve dhe metodologjinë e zbërthimit të përmbajtjes së lëndëve, kur planifikon dhe zhvillon veprimtari mësimore. Në këtë mënyrë ai është në gjendje të organizojë njohuritë, të mundësojë integrimin e aftësive ndërdisiplinore dhe të bashkëpunojë me mësuesit e zakonshëm të klasës.

4.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 4.2.1 kupton konceptet kryesore, strukturën e lëndëve dhe përmbajtjen e fushave kurrikulare që jep mësim dhe mund të organizojë këto njohuri, të integrojë aftësi ndërlendore dhe të nxissë përparim në të nxënët e fëmijës me aftësi të kufizuara;
- 4.2.2 kupton dhe përdor njohuritë e përgjithshme dhe të specializuara të përmbajtjes në të gjithë fushat kurrikulare për të individualizuar mësimdhënien përfshirë me aftësi të kufizuara;
- 4.2.3 modifikondhe përshtat kurrikulat e përgjithshme dhe të specializuara përfshirë ato të aksesueshme dhe përdorshme përfshirë me aftësi të kufizuara;
- 4.2.4 përzgjedh, zbaton dhe vlerëson programet mësimore, apo pjesë të tyre, që rrisin pjesëmarrjen sociale të fëmijës në aktivitetet e klasës, shkollës, familjes dhe komunitetit;
- 4.2.5 përzgjedh dhe zhvillon kurrikulat që kanë në fokus fushat e aftësive përfshirë jetën: shtëpiake, rekreacion/kohë të lirë, profesionale, komunitare etj;
- 4.2.6 vlerëson burimet mësimore dhe materialet kurrikulare përfshirë gjithëpërfshirjen, saktësinë dhe dobinë e tyre;
- 4.2.7 ofron dhe rekomandon për prindin materiale didaktike dhe përmbajtje kurrikulare që mbështesin të nxënët e fëmijës me aftësi të kufizuara.

STANDARDI 5: Vlerësimi

5.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës përdor metoda të shumta vlerësimi dhe burime të dhënash në marrjen e vendimeve pedagogjike. Ai ku ton përdorimin e duhur dhe kufizimet e llojeve të ndryshme të vlerësimit dhe bashkëpunon me mësuesit e klasës, familjet dhe kolegët për të siguruar vlerësim të paanshëm dhe kuptimplotë. Ai kryen vlerësime formale dhe joformale të sjelljes, të të nxënët dhe arritjeve për të individualizuar përvojat e të nxënët që mbështesin rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

5.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 5.2.1 përdor metoda të ndryshme vlerësimi për arritjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara bazuar në pritshmëritë e përcaktuara në Planin Edukativ Individual;
- 5.2.2 zgjedh dhe përdor vlerësime formale dhe joformale profesionalisht korrekte, që minimizojnë paragjykimet;
- 5.2.3 krijon dhe mban shënimë të qarta dhe të sakta për progresin dhe arritjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 5.2.4 inkurajon përpjekjet e nxënësit me aftësi të kufizuara dhe njeh e motivon mundësitetë dhe arritjet e tij;
- 5.2.5 përdor njohuritë mbi parimet dhe praktikat e matjes së arritjeve për të interpretuar rezultatet e vlerësimit dhe për të udhëhequr vendimet pedagogjike për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- 5.2.6 përdor lloje të ndryshme vlerësimi dhe grumbullimi të dhënash, në bashkëpunim me kolegët dhe familjen, për të mundësuar marrjen e vendimeve për fëmijën me aftësi të kufizuara. dhe raportimin e rezultateve;
- 5.2.7 bashkëpunon me familjet dhe profesionistë të tjera në kryerjen e vlerësimit individual dhe raportimin e rezultateve të vlerësimit;
- 5.2.8 përdor të dhënat e performancës për të bërë ose sugjeruar modifikimin e duhur në mjetet e të nxënët, kurrikulën e zbatuar dhe/ose strategjitet mësimore;

- 5.2.9 Informon prindërit ose kujdestarët në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike për ecurinë e fëmijës.

STANDARDI 6: Planifikimi dhe strategjiti e mësimdhënies

6.1 Përshkrimi i standardit

Vendimmarja e individualizuar dhe mësimdhënia e individualizuar janë në qendër të praktikës së pedagogjisë speciale. Në përgjedhjen, zhvillimin dhe përshtatjen e përvojave të të nxenit përfëmijët me aftësi të kufizuara, mësuesit ndihmës marrin parasysh aftësitë, interesat, mjediset e tē nxenit dhe faktorët kulturorë dhe gjuhësorë. Ndërveprimet e këtyre faktorëve me implikimet e paaftësisë së fëmijës orientojnë përgjedhjen, përshtatjen dhe përdorimin nga mësuesi ndihmës tē repertorit të strategjive mësimore, në promovimin e rezultateve pozitive të tē nxenit në përgjithësi dhe kurrikulës së specializuar si dhe modifikimin e mjediseve mësimore në mënyrë tē përshtatshme përfëmijët me aftësi të kufizuara.

6.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 6.2.1 zhvillon plane edukative mësimore tē përshtatshme që zbërthejnë kurrikulën zyrtare dhe strategjitet mësimdhënëse me qëllime dhe standarde të individualizuara arsimore.
- 6.2.2 zhvillon dhe zbaton plane edukative individuale përfëmijët me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me kolegë, familjet dhe specialistë tē fushës;
- 6.2.3 përgatit në bashkëpunim me mësuesin e klasës, anëtarë tē tjerë tē stafit tē shkollës dhe prindin, materiale didaktike dhe mjete tē thjeshta mësimore përf tē mbështetur tē nxenit e fëmijës me aftësi të kufizuara;
- 6.2.4 vlerëson kurrikulën e përgjithshme dhe përcakton shtrirjen dhe renditjen e fushave tē përmbytjeve akademike;

- 6.2.5 zgjedh dhe vlerëson burime dhe materiale që janë të vlefshme në aspektin zhvillimor dhe funksional të fëmijës me aftësi të kufizuara;
- 6.2.6 zgjedh, përshtat dhe përdor një repertor të gjerë të strategjive mësimore të bazuara në evidenca, për të nxitur dhe mbështetur të nxënит;
- 6.2.7 zgjedh dhe përdor strategjitet e duhura mësimdhënëse për të përmbushur objektivat/rezultatet mësimore;
- 6.2.8 merr parasysh aftësitë individuale, interesat, mjediset e të nxënitet dhe faktorët kulturorë dhe gjuhësorë në përzgjedhjen, zhvillimin dhe përshtatjen e strategjive të mësimdhënies dhe nxënitet përfundimtës me aftësi të kufizuara;
- 6.2.9 përdor teknologjinë për të mbështetur vlerësimin, planifikimin, mësimdhënien dhe të nxënitet përfundimtës me aftësi të kufizuara;
- 6.2.10 përdor strategji përfundimtës rritur zhvillimin gjuhësor dhe aftësitë e komunikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- 6.2.11 ndërton veprimtari mësimore bazuar në njoħuri dhe aftësi ndérdisiplinore si mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve përfundimtës me aftësi të kufizuara.

STANDARDI 7: Komunikimi dhe bashkëpunimi

7.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës bashkëpunon me familjet, kujdestarët, mësuesit e tjerë, ofruesit e shërbimeve përkatëse, individët me aftësi të kufizuara dhe personelin nga agjencitë e komunitetit në mënyrë të përgjegjshme përfundimtës adresuar nevojat e fëmijës me aftësi të kufizuara në një sërë përvojash të mësuarit. Një nga kërkesat e rëndësishme në arsim është krijimi i ekipeve arsimore bashkëpunuese përfundimtës adresuar nevojat edukuese të nxënësve. Diversiteti i nxënësve, kompleksiteti i kërkesave kurrikulare, ndikimi në rritje i teknologjisë ka nxjerrë në pah nevojën përfundimtës ekipe edukatorësh që bashkëpunojnë së bashku përfundimtës siguruar që të gjithë nxënësit janë përfshirë në procesin e të nxënitet efektiv.

7.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 7.2.1 përdor elementet e komunikimit e bashkëpunimit efektiv dhe shërben si mbështetje për kolegët;
- 7.2.2 e ndjen veten si pjesë të një ekipi që punon për të njëtin qëllim dhe e koncepton e planifikon punën e tij duke u mbështetur e bashkëpunuar me mësuesit, drejtuesit, shërbimin psiko-social, prindin dhe komunitetin;
- 7.2.3 i sheh mësuesit e klasës si bashkëpunëtorët kryesorë në mbështetje të zhvillimit dhe edukimit të fëmijës me aftësi të kufizuara dhe për të krijuar një mjedis efektiv të nxënë për të;
- 7.2.4 mirëpret dhe nxit nismat e kolegëve për përmirësimin e kushteve të të nxënët;
- 7.2.5 mbështet dhe ndihmon mësuesit ndihmës të rinj;
- 7.2.6 bashkëpunon në ekip, duke përfshirë familjet, për të zhvilluar dhe zbatuar planin edukativ individual të fëmijës dhe mbështetjen në zhvillimin e eksperiencave të ndryshme të të nxënët;
- 7.2.7 e përdor bashkëpunimin për të promovuar mirëqenien e fëmijëve me aftësi të kufizuara në një gamë të gjerë mjedisesh dhe bashkëpunëtorësh;
- 7.2.8 bashkëpunon dhe përfshin familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuar në të gjithë aspektet e edukimit të fëmijës;
- 7.2.9 inkurajon dhe mbështet familjet në programet e edukimit të fëmijëve të tyre dhe i nxit për t'u bërë pjesëmarrës aktivë në ekipin edukativ;
- 7.2.10 u siguron prindërve informacionet e nevojshme dhe në kohën e duhur për arritjet e fëmijës së tyre;
- 7.2.11 bashkëpunon dhe koordinon me anëtarë të shërbimit psiko social në shkollë dhe në rajonin ku shkolla funksionon.
- 7.2.12 bashkëpunon me profesionistë në qendrat komunitare të shërbimeve sociale dhe institucionale të tjera të specializuara në komunitetin e institucionit arsimor.

STANDARDI 8: Zhvillimi profesional dhe personal

8.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ndihmës përdor njojuritë themelore të fushës dhe parimet e tij profesionale dhe etike për të mbështetur praktikën e pedagogjisë speciale, për t'u angazhuar në të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe për të avancuar profesionalisht. Mësuesi ndihmës e kupton mësimdhënien si profesion, ruan standardet e sjelljes profesionale dhe siguron udhëheqje për të përmirësuar të nxënët dhe mirëqenien e fëmijëve.

8.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi ndihmës:

- 8.2.1 përdor parimet e etikës profesionale dhe standardet profesionale për të udhëhequr praktikën e tyre të përditshme;
- 8.2.2 shfrytëzon të gjitha burimet dhe mundësitë për zhvillimin e tij profesional në fushën e arsimit special;
- 8.2.3 kupton se si njojuritë themelore dhe çështjet aktuale ndikojnë në praktikën profesionale;
- 8.2.4 reflekton mbi praktikën e tij/saj për të përmirësuar mësimdhënien dhe për të udhëhequr rritjen profesionale;
- 8.2.5 kupton rëndësinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe merr pjesë në aktivitetet profesionale dhe komunitetet profesionale të të mësuarit;
- 8.2.6 siguron që plani i tij/saj i zhvillimit profesional të përfshijë aktivitete që do të mbeten aktuale në lidhje me praktikën mësimdhënëse dhe nxënëse;
- 8.2.7 studion rregullisht literaturë profesionale nga burime të ndryshme, përfshirë dhe atë elektronike, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj;
- 8.2.8 ofron udhëzime dhe orientim për prindërit, mësuesit praktikantë dhe vullnetarët.
- 8.2.9 vlerëson rregullisht veten mbi bazën e standardeve profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit dhe standardeve të mësuesit ndihmës;
- 8.2.10 njeh shenjat e shqetësimit emocional, abuzimit të fëmijëve dhe neglizhencës dhe ndjek procedurat për raportimin e abuzimit tek autoritetet përkatëse;
- 8.2.11 ruan konfidencialitetin e të dhënavë mjekësore dhe akademike dhe respekton privatësinë e individëve me aftësi të kufizuara;

- 8.2.12 përdor me efektivitet kohën e punës;
- 8.2.13 kujdeset për kushtet shëndetësore, të higjenës dhe të sigurisë nga rreziqet në mjediset e mësimdhënies;
- 8.2.14 parandalon dhe përdor metoda të negocimit, të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe të arritjes së konsensusit në marrëdhëniet me kolegët, prindërit/kujdestarët e fëmijës dhe bashkëpunëtorë të tjere.

